



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **II-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2023**.

Seanca mbahet më **28.02.2023** (e Martë), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00**.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022 (ref nga ekz.),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 (ref.drejt fin.),
6. Shqyrtimi dhe miratimi propozim-vendimit të DUMM për destinimin e parcelës Nr.00109-0 ZK. Dolle-Klinë për ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit (ref. DUMM),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të DUMM për vënie në diskutim publik drafr-rregullorën komunale për bonuse të zonimit për Komunën e Klinës (ref.DUMM),
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit të zyrës për Komunitete dhe Kthim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete (ref. Zyra për Komunitete dhe Kthim),
9. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-5144 2023
Klinë, me 15.02 2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi